

KONTRATË BINJAKËZIMI

Përkrahje për Statistikat

Kosovë



RAPORT MBI MISIONIN

Aktiviteti 2.6.3: Vazhdim i përkrahjes në përpilimin e Llogarive Kombëtare në Kosovë, me fokus në tabelat ofruese-përdoruese

Komponenti nr 2 Llogaritë Kombëtare

Misioni i udhëhequr nga
Søren Larsen, Jens Holst Jensen dhe Maria Nilsson
Statistikat e Danimarkës

7-11 Dhjetor 2015

IPA 2012

Emri i autorit, adresa, e-maili

*Søren Larsen
Statistics Denmark
Sejrøgade 11
DK-2100 Copenhagen Ø
Denmark
Tel: +45 39173483
Email: shl@dst.dk*

*Jens Holst Jensen
Statistics Denmark
Sejrøgade 11
DK-2100 Copenhagen Ø
Denmark
Tel: +45 39173484
Email: jhj@dst.dk*

*Maria Nilsson
Statistics Denmark
Sejrøgade 11
DK-2100 Copenhagen Ø
Denmark
Tel: +45 39173679
Email: mnn@dst.dk*

Përmbajtja

1. Komentet e Përgjithshme	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
2. Vlerësimet dhe rezultatet.....	4
2.1 Vazhdim i kodimit të burimit të dhënave.....	4
2.2 Burimi i të dhënave të koduara në dispozicion nga misioni i kaluar.	5
2.3 Statistikat e ASN-së për 2013.	5
2.6 PRODCOM statistikat për 2014.....	5
2.7 Qeveria e përgjithshme.	5
2.8 Krijimi i një manuali që grumbullon të dhëna mbi outputet dhe inputet e industrisë ne total:	5
2.9 Krahësimi i strukturës së outputit dhe inputit.	6
2.9 Korniza SUT ne rrjet.....	6
3. Konkluzionet dhe rekomandimet.....	6
Aneksi 1. Termat e Referencës.....	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
Aneksi 2. Personat e takuar	12

Lista e Shkurtesave

CPA	Klasifikimi Statistikor i Produkteve sipas Aktivitetit në Komunitetin Ekonomik Evropian
ABEF	Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
NACE	Nomenklatura e veprimtarive ekonomike
PRODCOM	Lista e Produkteve në Komunitetin Evropian
ASN	Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve
SUT	Tabelat Ofruese-Përdoruese
TeR	Termat e Referencës

1. Komentet e përgjithshme

Ky raport mbi misionin është përgatitur në kuadër të Projektit të Binjakëzimit 'Përkrahje për Statistikat'. Është misioni i tretë, që i kushtohet përpilimit të Tabelave Ofruese-Përdoruese për vitin 2013 në kuadër të komponentit 2 të projektit, Llogarive Kombëtare. Ky mision ka pasur për qëllim vazhdimin e punës në përgatitjen e të dhënave për tu përdorur në kornizën e tabelave ofruese përdoruese. Kjo punë ka filluar në dy misionet e kaluara, por burimet e të dhënave që kanë qenë në dispozicion kanë pasur nevojë për validim dhe korrigjim të mëtejshëm.

Objektivat konkrete të misionit ishin:

- Të vazhdohet me kodimin dhe formatizimin e burimit të dhënave, që ka filluar në misionin e kaluar.
- Të kalkulojen shifrat sipas koncepteve të Llogarive Kombëtare prej dy burimeve të reja të të dhënave 'ASN 2013' dhe 'PRODCOM 2014', dhe të kodohen dhe formatizohen rezultatet.
- Të krijohet një hapësirë në rrjetin e kompjuterik të ASK-së ku mund të ruhen dhe të gjenden korniza e Excel-it që përmban inputet për tabelat ofruese përdoruese, versioni aktual i kornizës SUT dhe korrigjimet e bilanceve fillestare të produkteve.

Fatkeqësisht, ky mision ka qenë më i shkurtër pasi nuk kemi arritur në Prishtinë deri të martën. Kur kemi arritur të dielën nga Kopenhaga në Vjenë, e kemi kuptuar që fluturimi për në Prishtinë është anuluar. Ka pasur shumë mjegull në Vjenë dhe fluturimi për Prishtinë ka qenë i pamundur. Për këtë arsye e kemi rezervuar fluturimin të nesërmën. Të hënën kemi fluturuar nga Vjena mirëpo pas tentimit të pasukseshëm për të ateruar në Prishtinë, jemi detyruar të kthehemi përsëri në Vjenë. Edhe njëherë e kemi rezervuar fluturimin për të nesërmen. Pasagjerët ishin të shqetësuar se mund të ktheheshim përsëri në Vjenë, për arsye të motit, mirëpo kësaj here ateruam. Të martën pasdite kemi arritur në ASK, për të diskutuar me stafin.

Koha e humbur ka ndikuar deri diku në të arriturat e misionit. Megjithatë, pasi ishim tre konsulentë kemi arritur t'i diskutojmë shumicën e çështjeve, të parapara me program. Të dhënat për outputin dhe inputin e qeverisë së përgjithshme janë kompletuar gjatë misionit.

Në veçanti "ASN 2013" dhe "PRODCOM 2014" janë përgatitur në atë mënyrë që e bëjnë të mundur prodhimin e të dhënave-input për SUT, por do të jetë e nevojshme të korrigjohen një numër i konsiderueshëm i gabimeve në tabela dhe të kodohet pjesa e inputit të statistikave 'PRODCOM' para se të përdoren të dhënat. Kjo, nëse është e mundur, duhet të përfundojë para misionit të radhës.

Është diskutuar orari për misionet e radhës. Konsulentët danezë kanë propozuar një mision sa më parë që është e mundur në Janar, një mision në fillim të Shkurtit, si dhe një mision në fund të Shkurtit.

Konsulentët dëshirojnë të falënderojnë të gjithë zyrtarët dhe personat e takuar, për mbështetjen dhe informacionet e vlefshme që kanë dhënë, gjë që ka lehtësuar shumë punën e tyre gjatë qëndrimit në Kosovë.

Këndvështrimet dhe vëzhgimet e paraqitura në këtë raport janë ato të konsulentëve dhe jo domosdoshmërisht përputhen me këndvështrimet e BE-së, ASK-së apo Statistikave të Danimarkës.

2. Vlerësimi dhe rezultatet

2.1 Vazhdim i kodimit të burimit të dhënave.

Ky mision ishte kryesisht i përkushtuar në finalizimin e kodimit të të dhënave për qeverinë e përgjithshme dhe kodimin e burimeve të dhënave, që ishin në dispozicion para ose gjatë misionit në Tetor.

2.2 Burimet e të dhënave të koduara, në dispozicion nga misionet e kaluara.

Një numër i fushave kanë qenë në dispozicion gjatë misioneve të kaluara, disa prej tyre janë të gatshme të përdoren në kornizën SUT, ndërsa disa prej tyre duhet të kombinohen me të dhëna nga burimet e tjera para se të përdoren. Këto të dhëna mbulojnë këto fusha:

- Bujqësi
- Statistikat e TVSH-së
- Statistikat e ASN-së për 2012
- Importet dhe Eksportet e mallrave
- Anketa e buxhetit të ekonomive familjare

2.3 Statistikat ASN për vitin 2013.

Këto statistika kanë qenë në dispozicion, me titujt e përkthyer nga Gjuha Shqipe në Gjuhën Angleze. Pavarësisht normës së ulët të përgjigjeve, statistikat janë ngritur në pesha për të mbuluar ekonominë e vërtetuar dhe duket të ketë një mbulueshmëri të arsyeshme në krahasim me burimet e tjera. Para këtij misioni, janë shtuar disa tabela nga konsulenti danez. Këtu variablat e ASN-së janë përkthyer në koncepte, që nevojiten për qëllime të llogarive kombëtare. Ky aktivitet nxorri në pah faktin që nevojitet validim shtesë para se të largohen gabimet sinjifikante. Konsulenti do të hulumtojë se deri në çfarë mase mund të bëhen këto korrigjime në mënyrë automatike. Do duhej të jetë e mundur, për shembull, kur inventarët shfaqen si pjesë e aktivitetit të tregtisë në njësitë-prodhuese dhe anasjelltas. Disa korrigjime, megjithatë, do të duhej të bëhen në mënyrë manuale dhe për këtë do të duhet angazhimi i stafit të ASK-së.

2.6 Statistikat PRODCOM për vitin 2014.

Tashmë titujt janë edhe në gjuhën Angleze. Duket që janë ende burimi më i mirë për të dhënat mbi strukturat e produkteve dhe konsumit të ndërmjetëm për industritë prodhuese. Derisa pjesa e outputit është koduar sipas kodeve të produkteve që përdoren në SUT, strukturat e inputeve ende nuk janë të klasifikuara në mënyrë të njejtë sistematike. Të dhënat duhet të kodohen sipas përshkrimeve të inputeve në Gjuhën Shqipe. Puna është inicuar gjatë këtij misioni. Është krijuar një faqe e cila përmban një listë me të gjitha përshkrimet e ndryshme (në Gjuhën Shqipe) të produkteve që ekzistojnë në dosje. Shumë prej tyre kanë përshkrim të ndryshëm për të njejtin produkt dhe kodimi sipas kodeve të produkteve në SUT nuk duhet të jetë i vështirë. Megjithatë, kjo kërkon angazhim nga stafi i ASK-së.

2.7 Qeveria e përgjithshme.

Të dhënat për qeverinë e përgjithshme tashmë përmbajnë një kodim sistematik, përfshirë kodet-ESA dhe kodet e produkteve-SUT për shitje, konsumin e ndërmjetëm dhe investimet e kapitalit fiks bruto. Gjatë këtij misioni është krijuar një balancim i plotë i outputit të qeverisë për konsum dhe objektivate për prodhim, konsum të ndërmjetëm dhe formim të kapitalit fiks bruto për qeverinë e përgjithshme sipas industrive. Të dhënat e koduara për shitje, konsum të ndërmjetëm dhe formim të kapitalit fiks bruto po ashtu janë transformuar për të korrigjuar formatin dhe janë futur në kornizën SUT. Të dhënat e azhurnuara për qeverinë e përgjithshme janë në dispozicion dhe stafi i ASK-së do të përcjellë hapat e njejtë për kodim dhe formatizim dhe do të fusë të dhënat e azhurnuara në kornizën SUT, pas këtij misioni. Gabimet në kodim të qeverisë së përgjithshme janë zbuluar kur janë futur shifrat në kornizën SUT. Disa prej tyre janë korrigjuar gjatë këtij misioni dhe disa të tjera do të korrigjohen nga ASK kur të azhurnohen të dhënat.

2.8 Krijimi i një manuali që grumbullon të dhëna mbi totalët e outputit dhe inputit të industrisë:

Është krijuar një manual, që përmban tabela të ndara për burime të ndryshme të të dhënave, që duhet të shtohen së bashku për të krijuar objektivat për totalin e prodhimit dhe konsumit të ndërmjetëm sipas industrive si dhe totalin e kolonave për importe, eksporte dhe përdorim final. Totalët e industrive

duhet të krahasohet me totalet e ngjashme nga llogaritë kombëtare aktuale dhe diferenca duhet të shpjegohet, sa më shumë që është e mundur. Pasi të dhënat nga burimet statistikore nuk korrespondojnë plotësisht me konceptet e ngjashme të llogarive kombëtare, manuali duhet të përmbajë pjesë, që shfaqin korrigjimet që janë të nevojshme, p.sh. për FISIM, përdorimi i shërbimeve të sigurimit etj.

2.9 Krahasimi i strukturave të outputit dhe inputit.

Kur statistikatat e TVSH-së, statistikatat e ASN-së 2012 dhe 2013 dhe PRODCOM 2014 janë në dispozicion, do të jetë e mundur të kombinohen të dhënat në tabela, si bazë për vendimet e strukturave të kolonave, që do t'i përdorim fillimisht për SUT, të pabalancuara.

2.9 Korniza SUT në rrjet.

Është ndarë një hapësirë në server për SUT dhe dosjet që do të përmbajnë kalkulimin e inputeve në kornizën SUT. Është ofruar një structure mbështetëse siç përshkruhet në raportin e tetorit. Personat, që janë duke punuar në SUT, kanë qasje në server. Versioni më i ri Excelit për SUT dhe, pak a shumë versionet finale të manualeve, që përmbajnë të dhënat-inputet, janë transferuar në server. Ende ka nevojë të caktohet një person, ose më shumë, që do të jetë përgjegjës për ruajtjen qendrore të dhënave.

3. Konkluzionet dhe rekomandimet.

Për shkak të problemeve me trafikun ajror, ky mision ka qenë më i shkurt. Megjithatë, pak a shumë, janë adresuar çështjet kryesore. Të dhënat mbi qeverinë e përgjithshme janë në një fazë, ku të dhënat e inputit dhe outputit janë koduar sipas produkteve dhe industrive dhe vlerat janë futur në Excel të kornizës SUT. Të dhënat e azhurnuara për qeverinë e përgjithshme janë në dispozicion dhe do të kodohen dhe futen në kornizën SUT nga stafi i ASK-së, pas misionit. Puna rreth ASN dhe PRODCOM nuk ka përfunduar dhe do të vazhdojë gjatë misionit të radhës. Pasi të jenë hequr një numër gabimesh nga të dhënat e ASN, këto të dhëna (në kombinim me statistikatat e TVSH-së) do të jenë burimi kryesor për totalet e outputeve dhe inputeve për ato industria, që mbulohen nga këto statistika. Të dhënat e detajuara të industrisë për tregti do të përdoren për të vendosur një shpërndarje të marzhave të tregtisë sipas produkteve. Statistikatat e TVSH-së do të formojnë bazën për shpërndarje të TVSH-së jo të zbritshme sipas produkteve dhe industrive.

Gjatë misionit, stafi i ASK-së e ka cekur që disa të dhëna-inpute të përdorura në kalkulimet e mëhershme duhet të azhurnohen. Një shembull i kësaj janë të dhënat e përmendura më lart mbi qeverinë e përgjithshme. Po ashtu, kishte vullnet të përmirësohet metoda e përdorur për ngrijten të pesha të të dhënave nga anketa e buxhetit të ekonomive familjare. Preferohet që përmirësimet e tilla të implementohen në tërësi para misionit të radhës, pasi është e rëndësishme të shtyhet përpara procesi i plotësimit të kornizës SUT. Po ashtu, është me rëndësi që në këtë moment detyra kryesore të jetë kodimi i inputit PRODCOM dhe korrigjimi i gabimeve në ASN të 2013.

Duke vënë bahskë të gjitha informatat mbi outputet, inputet dhe përdorimet finale, si dhe shpërndarjet e marzhave të tregtisë, taksave dhe TVSH-së, duhet të presim derisa të jenë të gatshme të dhënat e fundit-inputet. Bilancimi i anës ofruese dhe asaj përdoruese nuk mund të realizohet derisa të plotësohet tërësisht me të dhëna korniza e SUT. Pasi disa misione të mëhershme janë shtyrë për shkak të mungesës së burimeve të të dhënave të rëndësishme, rekomandohet të mbahen edhe tre misione, në Janar dhe Shkurt të vitit 2016.

Veprimet që duhet ndërmerren për përgatitjen e misionit të radhës

Veprimi	Afati kohor	Personat përgjegjës
---------	-------------	---------------------

Kodimi dhe formatizimi i të dhënave ASN 2013.	Para misionit të radhës	Ekspertët danezë: Korrigjimi automatik i gabimeve, aty ku është e mundur. Stafi i ASK: Gabimet e mbetura.
Kodimi i PRODCOM 2014.	Para misionit të radhës	Stafi i ASK: Korrigjimi i gabimeve në kodimin e outputeve të industrisë. Kodimi i inputeve bazuar në përshkrimet e produkteve në Gjuhën Shqipe

Aneksi 1. Termat e Referencës



Projekti i Binjakëzimit i BE-së KS12 IB ST 01 Përkrahja për Statistika

Komponenti 2: Llogaritë Kombëtare

Aktiviteti 2.6.3: SUT aktiviteti III

**Vazhdim i përkrahjes në përpilimin e llogarive kombëtare
në Kosovë, me fokus në tabelat ofruese përdoruese**

Orari:

TeR –data e përgatitjes: 19 Nëntor 2015

Fillimi / fundi i aktivitetit: 7-11 Dhjetor 2015

Koha e raportimit: 18 Dhjetor

Rezultatet obligative të komponentit:

Rezultati obligativ	Intervenimi logjik	Pikë referimi	Burimi i informacionit	Sugjerimet
2.3.1	Përkrahje në implementimin e Planit të Veprimit për Llogaritë Kombëtare Vazhdim i përkrahjes në implementimin e Planit të Veprimit për Llogaritë Kombëtare Përkrahja finale në implementimin e Planit të Veprimit për Llogaritë Kombëtare	- Raportet e misioneve, të publikuar në faqen e internetit të projektit - Fushat e caktuara të Llogarive Kombëtare, të përditësuara sipas ESA2010	- Raportet tremujore të projektit të Binjakëzimit - Raporti i Misionit - Plani i veprimit, i përditësuar	- Kapacitet i mjaftueshëm i absorbimit - Numër i vogël i stafit i involvuar në implementim - Stafi punon në realizimin e dytrave, që lidhen me projektin në mes të misioneve - Qasje në statistikat primare të sakta - Termat e referencës, të përpiluara me kohë, që paraqesin në detaje detyrat, rezultatet e pritura, pjesëmarrësit në aktivitet dhe

				agjendën
--	--	--	--	----------

Subjekti / qëllimi i aktivitetit: 2.6.3

Përkrahja në përpilimin e Llogarive Kombëtare në Kosovë. Fokus në Tabelat ofruese-përdoruese (SUT). Ky mision është vazhdimësi e misionit me Z. Søren Larsen dhe Jens Holst Jensen 2.6.2 në Tetor 2015. Misioni në Tetor ka konkluduar që:

Statistikat PRODCOM për vitin 2014 supozohet të jenë burimi më i mirë i informatave mbi strukturat e produkteve për outputet dhe inputet në industrinë prodhuese. Anketa nuk ka qenë në dispozicion deri në fillim të Tetorit. Ne e kemi konsideruar si të përshtatshme të mos mbahet misioni aktual para se të jenë në dispozicion këto statistika. Tani, kjo anketë mundëson të kodohet pjesa e outputit. Pjesa e inputit ende ka nevojë të klasifikohet në mënyrë sistematike. Të gjitha përshkrimet e inputit janë në Gjuhën Shqipe; kodimi duhet të bëhet në bashkëpunim në mes të ekspertëve danezë dhe stafit të ASK-së.

Puna e papërfunduar rreth burimit të të dhënave duhet të vazhdojë në misionin e radhës, ku shpresojmë të jetë e mundur të përfundojë kodimi dhe formatizimi. Pastaj do të jetë e mundur të bëhen kalkulimet, që janë të nevojshme për të vendosur një grup të objektivave fillestare, për totalët e kolonave në SUT, që janë outputi dhe importet në çmime bazë, konsumi i ndërmjetëm dhe konsumi final sipas kategorive përfshirë eksportet në çmime blerëse.

Para misionit të radhës, duhet të vendoset një kornizë qendrore e SUT në serverin e rrjetit, ku mund të kenë qasje të gjithë personat, që janë duke punuar në të dhënat - inpute.

Gjatë misionit në Tetor 2015 është dakorduar plani si në vijim:

Veprimi	Afati kohor	Personat përgjegjës
Validimi i inputeve të dhënave që janë koduar: Bujqësia Inputi dhe outputi i Qeverisë Konsumi i Ekonomive familjare	Në fillim të misionit të radhës	ASK:
Kodimi i burimeve të të dhënave shtesë për outputet: Statistikat e TVSH-së ASN 2013 PRODCOM 2014	Para misionit të radhës Para misionit të radhës Gjatë misionit të radhës	Ekspertët danezë “ “ ASK dhe ekspertët
Strukturat e inputit: ASN 2013 PRODCOM	Do të filloj para misionit të radhës Gjatë misionit të radhës	Ekspertët danezë ASK

Rezultatet e pritura nga aktiviteti 2.6.3:

Raporti i misionit, që përshkruan rezultatet e kodimit të dhënave, që do të përdoren për SUT

Rekomandimet për SUT në të ardhmen në ASK

Përshkrimi i punës së bërë gjatë misionit dhe punës që duhet bërë para fillimit të aktiviteti të radhës

Stafi i ASK-së:

Xhevdie Fetahu, Shefe e Divizionit të Llogarive Kombëtare, Xhevdie.Fetahu@rksgov.net
 Ylli Shala, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Ylli.Shala@rks-gov.net
 Ilir Mazrekaj, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Ilir.Mazrekaj@rks-gov.net
 Emine Bajrami, Zyrtare e lartë e Llogarive Kombëtare, Emine.Bajrami@rks-gov.net
 Florije Krapit, Zyrtare e lartë e Llogarive Kombëtare, Florije.Krapit@rks-gov.net,
 Nysret Sylejmani, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Nysret.Sylejmani@rks-gov.net
 Besim Mehmeti, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Besim.Mehmeti@rks-gov.net
 Ilir.T. Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare, Ilir.T.Berisha@rks-gov.net

Ekipi i Projektit të Binjakëzimit i ASK-së:

Udhëheqës i Projektit në ASK, Z. Ilir T. Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare, Ilir.T.Berisha@rks-gov.net
 Homologu i RTA, Znj. Teuta Zyberi, Zyrtare e Lartë për Marrëdhënie me Jashtë, teuta.zyberi@rks-gov.net

Ekspertët e vendeve anëtare:

Z. Søren Larsen, Ekspert i LLK, Statistikat e Danimarkës, shl@dst.dk
 Z. Jens Holst Jensen, Këshilltar i Lartë, jhj@dst.dk
 Znj. Maria Nilsson, Këshilltare e Lartë, Statistikat e Danimarkës mnn@dst.dk

Stafi i Projektit të Binjakëzimit:

Z. Per Knudsen, RTA, pkn@dst.dk
 Znj. Nora Zogaj, asistente e RTA, nzogaj@yahoo.com

Përshkrimi i historikut për aktivitetet

Raporti i Vlerësimit të Adaptuar Global i vitit 2012 (AGA), i përgatitur nga Eurostat-i, deklaron në lidhje me Llogaritë Kombëtare (f. 53-54): Në vitin 2010, ASK-ja, me mbështetjen e IPA-s, ka përgatitur një 'Plan të veprimit për përpilimin dhe publikimin e statistikave gjithëpërfshirëse për llogaritë kombëtare dhe tregun e punës'. Ky plan është në parim një instrument i dobishëm për organizimin dhe zhvillimin e ardhshëm të Llogarive Kombëtare, së bashku me zhvillimin e standardeve dhe burimeve, që janë të nevojshme për rritjen e mbulueshmërisë dhe përmirësimin e të dhënave të llogarive kombëtare.

Projekti i Binjakëzimit deri tani ka pasur disa aktivitete në Komponentin #2 Llogaritë Kombëtare përfshirë misionin e gjetjes së fakteve mbi SUT

Aktivitetet, që duhet të ndërmerren në përgatitje të misionit:

- Raportet e misioneve të kaluara në komponentin e LLK. Të gjitha të publikuara në www.dst.dk/kosovo

Aktivitetet e pritura janë:

- Azhurnimi i planit të veprimit për përmirësimin e Llogarive Kombëtare me SUT
- Zhvillimi i planit të detajuar për veprimet e ardhshme mbi SUT nga programi i binjakëzimit
- Kodimi i të dhënave

Rezultatet e pritura janë:

- Raporti i misionit – sipas modelit
- Plani i detajuar për aktivitetet e mëtejme në komponentin 2 nga programi i binjakëzimit
- Versioni i azhurnuar i planit për SUT

- Lista e veprimeve që duhet të ndërmerren para misionit të ardhshëm

Aneksi 1. Programi, Dhjetor 2015

Dita	Vendi	Koha	Ngjarja
1	ASK	10:00	ASK: Rishikim i punës së bërë nga misioni i kaluar mbi SUT në Tetor 2015
		10:45	Pushim për kafe
		11:00	Diskutimi mbi planet për këtë javë
		12:00	Dreka
		13:30-15:30	Punë praktike me të dhënat për SUT
2	ASK	09:00-16:00	Punë praktike me të dhënat për SUT
3	ASK	09:00-16:00	Punë praktike me të dhënat për SUT
4	ASK	09:00-16:00	Punë praktike me të dhënat për SUT Diskutimi mbi rekomandimet Plani për misionin e ardhshëm dhe si të veprohet para misionit të radhës Shkrimi i raportit
5	ASK	10:00-12:00	Shkrimi i raportit Takim mes ekspertëve, udhëheqësit të komponentit dhe RTA

Aneks 2. Personat e takuar

ASK:

Xhevrie Fetahu, Shefe e Divizionit të Llogarive Kombëtare, Xhevrie.Fetahu@rksgov.net

Ylli Shala, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Ylli.Shala@rks-gov.net

Ilir Mazrekaj, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Ilir.Mazrekaj@rks-gov.net

Emine Bajrami, Zyrtare e lartë e Llogarive Kombëtare, Emine.Bajrami@rks-gov.net

Florije Krap, Zyrtare e lartë e Llogarive Kombëtare, Florije.Krapi@rks-gov.net,

Nysret Sylejmani, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Nysret.Sylejmani@rks-gov.net

Besim Mehmeti, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Besim.Mehmeti@rks-gov.net

Ilir.T. Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare, Ilir.T.Berisha@rks-gov.net

Stafi i Projektit të Binjakëzimit:

Z. Per Knudsen, RTA,

Znj. Nora Zogaj, asistente e RTA,

Përkthyesi (në disa misione)